

Family & Community Academy of Worcester

Struktura e Programit

Kush jemi ne

Akademia e Familjes & Komunitetit të Worcester-it (The Family & Community Academy of Worcester) është një partneritet ndërmjet disa organizatave të komunitetit dhe Shkollave Publike të Worcester-it.

Misioni/Qëllimi

Misioni i Family and Community Academy of Worcester është që të ndihmojë të gjithë prindërit/kujdestarët ligjorë dhe kujdestarët e tjerë në zhvillimin e aftësive dhe konfidencës për të mësuar gjatë gjithë jetës si dhe në angazhimin aktiv në zhvillimin e plotë të fëmijës.

Rreth nesh

Eshtë besimi ynë se prindërit/kujdestarët e angazhuar do të jenë në gjendje që të bëjnë një dallim real në jetën e fëmijës së tyre, si dhe në kualitetin e të mësuarit për nxënësit e gjithë komunitetit. Puna e Family & Community Academy of Worcester është e bazuar në demonstrimin e besimit dhe në praktikat më të mira të dokumentuara, se angazhimi i prindërve është një faktor kritik në suksesin e fëmijës. Ne punojmë për të ndihmuar prindërit/kujdestarët në ndihmën që ata u japin fëmijëve në aksesimin e mundësive që ofrohen në qytetin tonë për të forcuar kapacitetin e familjes, për të përkrahur në mënyrë eficiente individët e regjistruar në shkollat lokale, si dhe për masat e programit dhe rregullave edukative që forcojnë fëmijët nga lindja deri në klasën e 12-të në komunitetin tonë. Ne besojmë se nëse prindërit/kujdestarët angazhohen plotësisht në edukimin e fëmijëve të tyre dhe gjërave që kanë lidhje me mësimdhënien dhe mësimin e fëmijëve të tyre, atëherë ne do të shohim fitime të qëndrueshme në edukimin dhe rezultatet e jetës së nxënësit.

Family & Community Academy of Worcester do ta bëjë këtë duke:

- Publikuar dhe shpërndarë për prindërit/kujdestarët katalogë, në pranverë dhe vjeshtë, që kanë një varietet kurshesh FALAS të edukimit dhe të ngritjes-së-kapacitetit, seminarësh, dhe eventesh të ofruara në të gjithë komunitetin nga organizatat partnere të Family & Community Academy of Worcester.
- Ju përgjigjur nevojave të komunitetit dhe prioritetëve të Shkollave Publike të Worcester-it duke krijuar, formuar, dhe autorizuar kurse, seminarë dhe evente për të përmbushur këto nevoja.
- Ndihmuar në lehtësimin e koordinimit të përpjekjeve të ndryshme të të gjitha organizatave partnere për të maksimizuar impaktin në komunitet.

Qëllimet

- Ndërtimi i më shumë lidhjeve dhe i marrëdhënieve më të forta ndërmjet prindërve/kujdestarëve, shkollës, dhe ofruesve nga komuniteti si rezultat i Family & Community Academy of Worcester.
- Të asistojë dhe ndihmojë prindërit/kujdestarët që të ndikojnë pozitivisht në rezultatet mësimore të fëmijëve duke ngritur aftësitë, njohuritë dhe konfidencën e tyre.
- Fuqizimi i prindërve/kujdestarëve për të përkrahur efektivisht veten dhe fëmijët e tyre në Shkollat e Worcester-it dhe në komunitet.

Family & Community Academy of Worcester

Fushat e Fokusuara

Kurset dhe seminarët e Family & Community Academy of Worcester do të jenë në fushat e mëposhtme të fokusimi;

- **Mbrojtja/Përkrahja**
Prindërit/kujdestarët krijojnë aftësi për të mbrojtur fëmijët dhe familjen e tyre në shkollë dhe në komunitet.
- **Mjetet Mësimore**
Prindërit/kujdestarët do të mësojnë aftësi të reja për të mbështetur arritjet individuale të nxënësit në shkollë dhe më tej.
- **Momentet Kryesore të Zhvillimit Prindëror dhe të Fëmijës**
Prindërit/Kujdestarët krijojnë aftësi dhe kuptim të ri të zhvillimit të fëmijës, për të ndërtuar familje më të forta.
- **Kultura & Komuniteti**
Prindërit/kujdestarët ndërtojnë komunitetet duke ngritur diversitetin dhe mësimin rreth kulturave të ndryshme në qytetin tonë.

Llojet e Prezantimeve

Evenimentet që ofron Family & Community Academy of Worcester do të mbahen në shumëllojshmëri formatesh:

- **Evenimente me Grupe të Mëdha:** Konferenca që mund të përfshijnë një shumëllojshmëri seminaresh nga të cilët mund të zgjedhësh.
- **Klasa me Disa Seanca:** Takime në disa seanca gjatë disa javësh. Këto takime u japin mundësi prindërve/kujdestarëve për të krijuar njohuri më të mëdha ose për të praktikuar aftësi të rëndësishme që ndihmojnë mësimin.
- **Seminare:** një eveniment i ofruar për një temë të caktuar.
- **Klasa "To Go":** Disa partnerë mund të jenë në gjendje që të ofrojnë klasat/seminaret e tyre "to go", sipas kërkesës së një shkolle dhe/ose organizatave partnere. Marrëveshje të tilla do të bëhen rast pas rasti ndërmjet organizatave partnere përkatëse të mundësuar nga Komiteti Ekzekutiv.

Komunikimi/Promovimi

Adresa e internetit të shkollave Publike të Worcester-it do të ketë versionin në internet të katalogut të Family & Community Academy of Worcester, do të publikojë katalogun e kurseve dhe të gjitha evenimentet e Family & Community Academy of Worcester për prindërit/kujdestarët e Shkollave Publike të Worcester-it. Veç kësaj, organizatat partnere do të përhapin informacion në lidhje me kurset që ofrohen duke:

- Ndarë fletushka dhe/ose katalogë të plotë të kurseve nëpërmjet listës së përshtatshme postare klient/anëtar/partner.
- Ofruar një lidhje për tek katalogu nga faqja e adresës së tyre të internetit/medias sociale.

Family & Community Academy of Worcester

- Postuar dhe vënë në dispozicion fletushka të Family & Community Academy of Worcester në zyrat e tyre dhe në evenimentet publike.

Struktura Drejtuese



Komiteti Ekzekutiv

Komiteti Ekzekutiv është përgjegjës për përcaktimin e përgjithshëm të qëllimit, strukturës, vizionit dhe ofertave të Family & Community Academy of Worcester. Veç kësaj, ky grup është përgjegjës për përpunimin e detajeve për vendosjen e ideve të mëdha në hapa të menaxhueshëm veprimi- këto përfshijnë koordinimin e kurseve, shërbimeve, dhe resurseve që ofrohen nga organizatat partnere dhe konsultuese si dhe vullnetarët. Komiteti ekzekutiv duhet që të kërkojë këshilla dhe reagime nga Bordi Udhëzues (The Advisory Board) për vendime të mëdha strukturore ose programuese.

Komiteti Ekzekutiv do të mbledhet sipas rrethanave- të paktën një herë në muaj. Në të gjitha mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv duhet të ketë 3-6 anëtarë, dhe duhet të ketë në çdo kohë të paktën një përfaqësues nga Shkollat Publike të Worcester-it dhe një përfaqësues nga Worcester Education Collaborative.

Anëtarët e propozuar të Komitetit Ekzekutiv:

Worcester Public Schools: *Director of Supplemental Academic Programs and Services*

Worcester Education Collaborative: *Executive Director and Assistant Director*

Worcester Community Connections: *School Liaison*

Latino Education Institute: *Executive Director*

Citywide Parent Planning Advisory Committee:

Bordi Udhëzues/Këshillues

Roli i Bordit Udhëzues është që ti japë udhëzime Komitetit Ekzekutiv në drejtimin e përgjithshëm të Family & Community Academy of Worcester. Nga organizatat anëtare të Bordit Udhëzues pritet që të

Family & Community Academy of Worcester

ofrojnë resurse dhe asistencë të arsyeshme në fushat e tyre të ekspertizës, përfshirë regjistrimin në evenimentet e edukimit të prindit/kujdestarit dhe evenimentet e ngritjes së kapacitetit që ata ofrojnë aktualisht në komunitet si pjesë e Family & Community Academy of Worcester. Organizatat anëtare të Bordit Udhëzues bien dakord që të publikojnë evenimentet/kurset Family & Community Academy of Worcester tek listat e klientëve/anëtarëve/bashkëpunëtorëve të brendshëm të tyre.

Bordi Udhëzues do të mbledhet të paktën një herë në tremuj. Organizatat anëtare duhet që të dërgojnë përfaqësuesin e duhur në të gjitha mbledhjet. Nuk ka limit në numrin e përfaqësuesve që vijnë nga çdo organizatë anëtare në mbledhjet e Bordit Udhëzues.

Organizatat Anëtare të propozuara në Bordin Udhëzues:

African Community Education
Citywide Parent Planning and Advisory Council
Edward Street Child Services
Latino Education Institute
Southeast Asian Coalition
Thom Child and Family Services – Worcester Early Intervention
United Way of Central Massachusetts
Worcester Community Connections (bashkëpunëtoresh me YOU, Inc.)
Worcester Education Collaborative
Worcester Public Schools

Partnerët/Sponsorat e Programit

Përveç organizatave anëtare të Bordit Udhëzues të Family & Community Academy of Worcester, partnerë/sponsorat e programit mund të përfshijnë gjithashtu edhe shkolla, kolegje, organizata të komunitetit, biznese lokale, agjensi të qeverisë, grupe të bazuara në besim etj. Partnerët/sponsorat e programit që nuk janë përfshirë aktivisht në Bordin Udhëzues vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm në suksesin e Family & Community Academy of Worcester. Partnerët/sponsorët e programit janin një përkrahje esenciale, siç është, dhënia e kurseve, ndihma financiare, objekte për klasat, ushqim për evenimentet, karta dhuratë dhe gjëra të tjera për tu dhënë si çmime ose incentiva, stazhe për të diplomuarit e Family & Community Academy of Worcester, dhe/ose shërbime dhe furnizime të tjera.

Organizatat e propozuara si Partnere/Sponsorizuese të Programit:

Kolegjet lokale: WSU, Clark, Holy Cross, UMass Med School, QCC, Becker, WPI, etc...
Kishat lokale: Belmont AME Zion, Christian Community Church/ICC, etc...
Boys & Girls Club
Girls, Inc
Mass EDCO
University of Massachusetts
Worcester Chamber of Commerce
Worcester Family Partnership
Dhe shumë të tjera!

Family & Community Academy of Worcester

Programet me Certifikatë

Si punon programi me certifikatë?

Family & Community Academy of Worcester do të ofrojë "Kredite Akademike" për pjesëmarrjen në kurset dhe seminaret e Family & Community Academy of Worcester. Family & Community Academy of Worcester ofron dy lloje certifikatash. Pjesëmarrësit që plotësojnë deri në fund të vitit shkollor kërkesat e cilësdo certifikatë kanë të drejtë që të marrin një certifikatë të Family & Community Academy of Worcester dhe të marrin pjesë në një ceremoni diplomimi nga Family & Community Academy of Worcester. Kreditet e Family & Community Academy of Worcester mund të kalojnë nga një vit në tjetrin.

- **Certifikata Bazë e Family & Community Academy**
 - **Certifikata Bazë (Core Certificate)** njihet pjesëmarrjen në një shkallë të lartë programesh që mbështesin prindërit/kujdestarët si mësues dhe nxënës. Për të marrë këtë certifikatë, pjesëmarrësit duhet që të mbledhin të paktën **15 kredite** nëpër të paktën dy Fusha Fokusimi të Family & Community Academy of Worcester.
- **Certifikata Drejtuese (Leadership Certificate) e Family & Community Academy**
 - **Certifikata Drejtuese** u jepet pjesëmarrësve që mbledhin të paktën 25 kredite nëpër të katërt Fushat e Fokusimit të Family & Community Academy of Worcester: të paktën pesë kredite në çdo kategori, dhe pesë kredite shtesë në një fushë të veçantë interesi.

Cfarë ka pas Diplomimit nga Family & Community Academy of Worcester?

- **Praktikë në një nga Organizatat Partnere të Family & Community Academy of Worcester**
- **Punë drejt diplomës së shkollës së mesme**
 - Lidhuni me programet GED/HiSet në Worcester Public Schools Adult Learning Center ose me organizata të tjera partnere
- **Shikoni për Kolegj dhe Trajnim Karriere**
 - Lidhuni me MassEdCo për konsultime për karrierë dhe arsimim post-sekondar.
- **Përfshihuni në shkollën e fëmijës tuaj**
 - Bëhuni anëtar i Site Council të shkollës
 - Bëhuni një vullnetar në shkollë
- **Regjistrohuni në më shumë kurse dhe seminarë të Family & Community Academy of Worcester**
 - Gjithmonë ka më shumë për të mësuar, tema të reja do të ofrohen në çdo simestër gjatë zgjerimit të rrjetit tonë!
- **Bëhuni një Këshilltar (Advisor) i Family & Community Academy of Worcester**
 - Shërbeni në Bordin Udhëzues të Family & Community Academy of Worcester
 - Veproni si pritës i një evenimenti të Family & Community Academy of Worcester

Family & Community Academy of Worcester

- Ofroni njohje për Family & Community Academy of Worcester në panaiet lokale ose evenimente të tjerë
- Asistoni me marketing ose me një tjetër komitet
- Ofroni përkthime gjuhësore
- ...dhe më shumë!